



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



RREGULLORE PËR LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E
PSIKOLOGËVE KLINIK

Prishtinë, 2024

KUVENDI I ODËS SË INFIERMIEREVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (OIK-së) në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 15, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës dhe nenit 2 paragrafi 4 të rregullores për licencimin dhe rilicencimin e profesionistëve të OIK, në mbledhjen e mbajtur me 28.06.2024, miraton këtë:

R R E G U L L O R E P Ë R LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E PSIKOLOGËVE KLINIK

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kriteret e licencimit, rilicencimit dhe menaxhimi i regjistrave për ushtrim të veprimtarisë të psikologëve klinik.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet për procedurat e licencimit dhe rilicencimit të psikologëve klinik.
2. Kjo rregullore përfshinë dispozita edhe për çështje të tjera që ndërlidhen me procesin e licencimit dhe rilicencimit të psikologëve klinik.
3. Kjo rregullore nuk zbatohet për licencimin dhe rilicencimin e psikologëve klinik me shtetësi të huaj.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Licencimi** – procedura për dhënien e lejes profesionistit shëndetësor që të merret me veprimtari shëndetësore në Kosovë dhe që është i autorizuar ta ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë;
 - 1.2 **Anëtarë** - nënkupton psikologun klinik;
 - 1.3 **Faksimili** – nënkupton vulën unike të cilën i licencuari e përdorë me rastin e lëshimit të dokumenteve dhe raporteve në bashkëngjitje të nënshkrimit personal të psikologut klinik;
 - 1.4 **Regjistri** – Regjistrat e Licencave, Regjistrat e Rilicencave si dhe Regjistrin e revokimit të licencave dhe rilicencave;

- 1.5 **Oda** – nënkupton Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë të Kosovës;
 - 1.6 **Komisionet** - Nënkupton Komisionin përkatëse për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinik;
 - 1.7 **EVP** – nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional; dhe
 - 1.8 **MSh** – nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë.
 - 1.9 **Psikolog klinik** - Profesionisti shëndetësor i licencuar nga Oda i cili ka të drejtë të ushtrojë profesionin i pavarur;
 - 1.10 **Bashkëpunëtor profesional i Psikologut klinik** - Profesionisti shëndetësor i licencuar nga Oda i cili mund të ushtrojë profesionin vetëm nën mbikëqyrje të psikologut klinik.
 - 1.11 **Zyra për Psikolog Klinik** – Zyra në kuadër të shërbimit profesional.
2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

Neni 4

Përgjegjësit e komisionit

1. Komisioni për licencim dhe rilicencim është komision i OIK (në vazhdim Oda) i cili ka këto kompetenca dhe përgjegjësi për psikolog klinik:
 - 1.1 Vendosjen në shkallë të parë mbi përmbushjen e kushteve për licencimin dhe rilicencimin e Psikologëve Klinik;
 - 1.2 Valorizimin e pikëve kredituese në rilicencim;
 - 1.3 Bashkëpunimin me organet e tjera të Odës me qëllim të përmbushjes së funksioneve të përgjithshme të Odës, dhe
 - 1.4 Kryejnë detyrat të tjera sipas akteve normative të miratuara nga organi kompetent i Odës.
2. Pjesa teknike e realizimit të fushëveprimit të përgjegjësive të komisionit nga paragrafi paraprak është përgjegjësi e zyrës për psikolog klinik në kuadër të shërbimit profesional të OIK.
 - 2.1 Mirëmbajtjen dhe menaxhimin e bazës së të dhënave përkitazi me regjistrin e profesionistëve të Odës të licencuar, të rilicencuar dhe atyre të cilëve u është revokuar licenca;
 - 2.2 Ekzekutimin e masave disiplinore lidhur me tërheqjen e përkohshme dhe të përhershme të licencës dhe fshirjen nga Regjistri i anëtarëve të Odës, në bazë të vendimit të formës së prerë të Këshillit Etik apo Gjyqi të Nderit.
3. Zyrës për psikolog klinik mund t'i barten edhe përgjegjësitë të tjera nga organet e Odës përshtatshëmrisht me natyrën e funksioneve themelore të parapara me këtë nen.

Neni 5

Përbërja dhe funksionimi i Komisionit për Licencimin dhe Rilicencimin e Psikologëve Klinik

1. Komisioni për Licencim dhe Rilicencim është komision i Odës, i cili propozohet nga Këshilli Drejtues dhe zgjidhet nga Kuvendi i Odës.
2. Puna dhe procedurat e vendimmarrjes së komisionit për Licencim dhe Rilicencim janë të rregulluara me Rregulloren e punës të organeve të Odës.
3. Mënyra e zgjedhjes, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit për licencimin dhe Rilicencimin e Psikologëve Klinik rregullohet me akt të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të Odës.

KAPITULLI II

LICENCIMI / RILICENCIMI I PSIKOLOGËVE KLINIK

Neni 6

Licenca e punës

Licenca e punës është dokument publik që dëshmon kompetencën profesionale të psikologut klinik për kryerjen e pavarur të veprimtarisë shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Neni 7

Detyrimi për licencim/rilicencim

1. Licencimi respektivisht rilicencimi është i detyrueshëm për të gjithë psikologët klinik për ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore nga profili përkatës sipas autorizimeve ligjore.
2. Licencimi / Rilicencimi është procedurë e veçantë administrative që ka karakter zyrtar dhe publik.
3. Regjistri i licencave mirëmbahet nga Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional të Odës. Regjistrat përmbajnë së paku të dhënat si:
 - 3.1 Emrin dhe Mbiemri i anëtarit;
 - 3.2 Numrin e Licencës;
 - 3.3 Profilin shëndetësor të anëtarit;
 - 3.4 Datën e lëshimit të Licencës;
 - 3.5 Datën e skadimit të Licencës.
4. Regjistri i revokimit të Licencave mirëmbahet nga Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional të Odës, ndërsa regjistri dhe përmbajnë së paku këto të dhëna:
 - 4.1 Emrin dhe Mbiemrin;
 - 4.2 Numrin e Licencës;
 - 4.3 Arsyen për të cilën revokohet licenca;
 - 4.4 Faktin se revokimi është i përkohshëm apo i përhershëm.

KAPITULLI III PROCEDURA E LICENCIMIT

Neni 8

Inicimi i procedurës për licencim/rilicencim

1. Procedura për licencim dhe rilicencim iniciohet nga anëtari i Odës ose personi i autorizuar i tij me parashtrimin e aplikacionit për licencim/rilicencim.
2. Anëtarët e odës apo personi i autorizuar nga ai, mund të iniciojë procedurën për rilicencim 90 (nëntëdhjetë) ditë para skadimit të afatit të licencës aktuale të punës dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të afatit të licencës;
 - 2.1. Për anëtarët të cilët veprojnë komfor afatit të përcaktuar për aplikim, Licenca paraprake vazhdon të jetë e vlefshme deri në nxjerrjen e vendimit për përmbushjen e kriterëve sipas aplikimit për rilicencim;
 - 2.2. Anëtarët të cilët nuk kanë respektuar afatin e paraparë në paragrafin 2, nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri në nxjerrjen e vendimin për përmbushjen e kriterëve sipas aplikimit për rilicencim;
3. Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional të Odës me rastin e pranimit të aplikacionit, parashtruesit i lëshon një vërtetim/konfirmim me të cilin dëshmohet dorëzimi i aplikacionit për licencim, respektivisht për rilicencim;
4. Aplikuesit të cilët e kanë respektuar afatin si në paragrafin e 2 të këtij neni, për të cilin OIK brenda afatit nuk ka mundur ta shqyrtoj aplikim, vërtetimin mbi mundësinë e ushtrimit të profesionit edhe pas skadimit të licencës mund ta marrin në administratën e OIK;
5. Mënyra e vlerësimit të pikëve kredituese lidhur me EVP-në, janë nën përgjegjësinë e Komisioneve për Rilicencim të OIK, dhe çështjet përkitazi me këtë procedurë si dhe kriteret e valorizimit rregullohen me rregulloren për EVP;
6. Për çdo mëdyshje rreth procedurës së valorizimit, Komisionet mund të kërkojnë opinionin e KEVP-së dhe Këshillit Drejtues.

Neni 9

Kushtet për licencim/rilicencim të Psikologëve Klinik

1. Psikologët klinik mund të licencohen si profesionistë shëndetësor apo bashkëpunëtorë profesional, duke plotësuar këto kushte:
 - 1.1 Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2 Të jetë i diplomuar bachelor në psikologji dhe master në lëminë e fushës së psikologjisë klinike, këshilluese, neuroshkencës dhe psikologjisë së përgjithshme dhe programeve që mund të baras vlerësohen me njërin nga programet e lartë cekura.
 - 1.3 Në rast se aplikuesi ka përfunduar studimet jashtë vendit, duhet dorëzuar vendimin e organit kompetent për nostrifikimin e diplomave të huaja;
 - 1.4 Të ketë dhënë provimin profesional për licencë;
 - 1.5 Të jetë i regjistruar dhe i anëtarësuar në Odë;
 - 1.6 Të ketë paguar taksën administrative;
2. Anëtarët e OIK për t'u rilicencuar duhet të plotësojë këto kushte:

- 2.1 Të ketë përmbushur kriterin e ndjekjes së EVP-së, të përcaktuar sipas rregullores për EVP apo në mungesë të pikëve kredituese të ketë dhënë provimin për vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive profesionale;
 - 2.2 Të dorëzojë licencën paraprake kopje;
 - 2.3 Ti ketë përmbushur obligimet ndaj OIK;
 - 2.4 Të ketë paguar taksën administrative.
3. Kriteri i cili duhet të plotësohet për të aplikuar për rilicencim janë 100 pikë të mbledhura nga edukimi i vazhdueshëm profesional.
 4. Programet valide të cilat mund të llogariten për edukim të vazhdueshëm duhet të jenë brenda fushës së psikologjisë klinike, këshillimore apo shëndetit mendor, në përputhje me rregulloren për EVP.
 5. Në rastet kur nuk plotësohen 100 pikë në afatin pesë-vjeçar nga edukimi i vazhdueshëm, kandidati duhet t'i nënshtrohet provimit për rilicencim, i cili organizohet në kuadër të Odës.
 6. Anëtarë i Odës i cili ka arritur moshën 65 vjeçare, në momentin e aplikimit duhet të sjell certifikatën mjekësore për punë se është i aftë për ushtrimin e profesionit;
 - 6.1 Kohëzgjatja e licencës së punës nga paragrafi paraprak është 2 vite;
 - 6.2 Kriteret e EVP-së përcaktohen përshtatshmërisht me kohëzgjatjen e licencës nga paragrafi paraprak;
 - 6.3 Taksa administrative për lëshimin e licencës nga paragrafi paraprak, paguhet në përpjesëtim me kohëzgjatjen e licencës së punës.

Neni 10

Rilicencimi i anëtarëve të cilët nuk përmbushin kriteret e EVP për rilicencim

1. Anëtarët të cilët nuk ka plotësuar kriteret e parapara për EVP, respektivisht nuk ka grumbulluar pikët e nevojshme përmes aktiviteteve, obligohet t'i nënshtrohet Provimit për rilicencim, për vlerësimin e njohurive/shkathtësive për lëminë e caktuar.
2. Kandidati për provim të rilicencimit duhet të dorëzojë kërkesën dhe taksën administrative.
3. Provimi për rilicencim organizohet nga Komisionet për vlerësimin e njohurive/shkathtësive (KVNJ).
4. KVNJ formohet nga Këshilli Drejtues i OIK. Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procedurës dhe organizimit të provimit për rilicencim në vartësi nga profili shëndetësor të anëtarit të Odës.
5. Anëtarët të cilët kanë licencë të skaduar për periudhën nga 6 muaj deri në 5 vite, i nënshtrohen provimit për rilicencim nga komisioni për provim.
6. Anëtarë i cili ka licencë të skaduar për periudhën prej 5 vite deri në 10 vite, obligohet të kryejë stazhin praktikë nga profili përkatës në kohëzgjatje deri në 3 muaj.
7. Anëtarë i cili ka licencë të skaduar për periudhën prej më shumë se 10 vite, obligohet të kryejë stazhin praktikë nga profili përkatës në kohëzgjatje deri në 6 muaj.
8. Periudha e mbajtjes së stazhit caktohet proporcionalisht me kohën e vonës në rilicencim, përkatësisht për çdo 20 ditë vonësë mbi afatet e përcaktuara në paragrafi 6 dhe 7 mbahet një ditë stazhi profesional.
9. Programi stazhit hartohet nga komisioni profesional i emëruar nga Këshilli Drejtues dhe miratohet nga KD.

10. Pas përfundimit të stazhit nga pika 8, kandidati i nënshtrohet verifikimit të aftësive dhe shkathtësive praktike të fituara gjatë stazhit profesional;
11. Vlerësimi i dijes do të bëhet përmes testimit teorik dhe praktik. Pjesa teorike e verifikimit bëhet përmes testeve, dhe hartohet nga KVNJ. Vlerësimi i suksesit: është: "kaluar" ose "nuk ka kaluar".
12. Kandidati që ka kaluar me sukses provimin vlerësues, i lëshohet një certifikatë nga KVNJ për përfundimin e suksesshëm të provimit, me çka përmbyllet procesi i rilicencimit dhe anëtari pajiset me licencë.
13. Nëse kandidati nuk e kalon provimin e rilicencimit është i detyruar t'i nënshtrohet provimit të dytë brenda tre (3) muajve nga data e provimit të parë.
14. Nëse edhe pas herës së tretë (3 muaj pas mbajtjes së herës së dytë të provimit) kandidati nuk e kalon vlerësimin përfundimtar ose nuk arrin atë, atëherë anëtari i nënshtrohet sërish stazhit profesional në periudhë prej 1 viti.
15. Taksa administrative për organizimin e provimit për rilicencim rregullohet me vendim të veçantë të miratuar nga Këshilli Drejtues i OIK.

Neni 11 **Barazvlerësimi**

1. OIK bën barazvlerësimin e programeve në aspektin përmbajtësor dhe kohor, në rast të mospërputhjes së thirrjeve profesionale me thirrjet e parapara me Ligj, duke licencuar në thirrjen më të përafërt që njeh ligji;
2. Çështjet procedurale rregullohen me akt të veçantë të Këshillit Drejtues.

KAPITULLI IV **KRITERET PËR PROCESIN E EDUKIMIT TË PSIKOLOGËVE KLINIK**

Neni 12 **Edukimi formal**

1. Studimet bazike në fushën e psikologjisë.
2. Studimet e magjistraturës(master) në fushën e psikologjisë klinike, psikologjisë këshilluese, neuroshkencës dhe psikologjisë së përgjithshme dhe programeve që mund të baras vlerësohen me njërin nga programet e mësipërme.
3. Studimet e doktoratës në fushën e psikologjisë klinike.
4. Për marrjen e licencës është i domosdoshëm niveli i magjistraturës në njërin nga programet e cekura në pikën 2 të këtij neni.
5. Për licencë të psikologut klinik mund të aplikojnë edhe bashkëpunëtorët profesional të Psikologut klinik të cilët kanë ushtruar profesionin në mënyrë të rregullt për 5 vite dhe që janë të evidentuar si bashkëpunëtorë profesional nga lëmia e psikologjisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve nga neni 78 i këtij ligji.

Neni 13

Baras vlerësimet e drejtimeve për licencim

1. Baras vlerësimi i programeve të reja bëhet duke konstatuar përputhshmërinë e këtyre programeve të paktën 80% me lëndët bazë të programit më të përafërt të Psikologjisë klinike (Pra që janë të barasvlershme në aspektin kohorë dhe përmbajtësor).
2. Konstatimi i përputhshmërisë së këtyre programeve bëhet nga Komisioni për licencimin dhe rilicencimin e psikologëve klinik.
3. Programet e bachelor dhe master nga shtete tjera, mund të merren parasysh për konstatim të përputhshmërisë, pasi të ofrohet dokumenti i nostrifikimit të diplomës nga kandidati.
4. Kërkesën për baras vlerësim të programit, mund ta ushtrojë institucioni arsimor (IAL) apo vet kandidati për licencim.
5. Për programin ekzistues që do të përdoret si kriter për baras vlefhtësimin e programeve të tjera, vendos Komisioni për licencimin e psikologëve klinik.

Neni 14

Licencimi si bashkëpunëtorë profesional

1. Si bashkëpunëtorë profesional mund të licencohen kandidatët të cilët studimet bazike i kanë të mbaruara në një fushë tjetër nga psikologjia por studimet e magjistraturës i kanë në njërën nga fushat bazike për licencim si psikolog klinik.
2. Kandidatët të cilët i kanë studimet bazike në fushën e psikologjisë, por studimet e psikologjisë nga magjistratura, nuk janë në njërën nga fushat bazike të përcaktuara në nenin 12 dhe nuk mund të baras vlerësohen me to duke për përmbushur kriterin prej 80% të përputhshmërisë.
3. Kandidatët të cilët nuk i kanë studimet sipas pikës 2 të nenit 12 mund të licencohen në cilësinë e psikologut klinik pas praktikimit të profesionit si bashkëpunëtor profesional në periudhë 5 vjeçare me rekomandim të një psikologu klinik dhe me dëshmi të vijueshmërisë së 200 orëve të mbikëqyrura në vit në institucionet e licencuara të shëndetit mendor, e fitojnë të drejtën e ushtrimit të profesionit të Psikologut Klinik.
4. Përmbajtjen e provimit profesional nga paragrafi 3 i këtij neni e përcakton komisioni i ekspertëve i themeluar nga KD në bashkëpunim me komisionin për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinik.
5. Kompetencat e Bashkëpunëtorëve Profesional rregullohen me akt të veçantë.

KAPITULLI V

RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE

Neni 15

Institucionet profesionale

Praktika profesionale mund të kryhet në institucionet e licencuara që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor, duke përfshirë:

- Klinikën Psikiatrike në kuadër të QKUK;
- Qendrat e Shëndetit Mendor;
- Shtëpitë për Integrim në bashkësi;
- Repartet e Psikiatrisë në Spitalet e Përgjithshme;
- Qendrat për Punë Sociale;
- Institucionet shëndetësore private psikiatrike-psikologjike të licencuara nga organi kompetent.

Neni 16

Procedurat për kryerjen e praktikës profesionale

Procedura për kryerjen e praktikës profesionale bazohet në Planin e Praktikës Profesionale për psikolog klinik të miratuar nga Bordi Qendror për regjistrim dhe licencim, duke u bazuar në udhëzimin administrativ 06/2017.

KAPITULLI VI

VENDIMARRJA E KOMISIONIT

Neni 17

Vendimarrja dhe lëshimi i licencës/rilicencës

1. Komisionet për Licencim / Rilicencim të psikologëve klinik do të shqyrtojnë dokumentacionin së bashku me aplikacionin dhe do të nxjerrë vendim për lëndën përkatëse në afat prej 45 (dyzetepesë) ditëve nga dita e dorëzimit të dokumenteve.
2. Me rastin e nxjerrjes së vendimit mbi licencim apo rilicencim, Komisioni mund që:
 - 2.1 Të aprovojë kërkesën për licencim apo rilicencim të aplikuesit me të cilën lëshon Licencën si rekomandim për Kryetarin e OIK për nënshkrimin e tij/saj;
 - 2.2 Të refuzojë licencimin apo rilicencimin e aplikuesit për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas kësaj rregulloreje.
3. Komisioni për licencim gjatë shqyrtimit të aplikacionit mund të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për licencim apo rilicencim, duke i dhënë afat parashtruesit që plotësimin e tillë ta bëjë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit, nëse parashtruesi nuk i përgjigjet afatit për plotësimin e dokumentacionit konsiderohet që nuk ka aplikuar fare.
4. Në procedurën e licencimit, zbatohet përshtatshmërisht rregullat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
5. Palët e pakënaqur ndaj vendimeve të Komisioneve për Licencim apo Rilicencim sipas paragrafit 2, me nën paragrafët 2.2 dhe 2.3 të këtij neni, mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimit të vendimit.

6. Në bazë të procesverbalit dhe vendimit të Komisionit për licencim apo rilicencim të konstatuar nga komisioni, kryetari i Odës nënshkruan licencën e punës e cila i dorëzohet personalisht parashtruesit.
7. Me rastin e dorëzimit të licencës, ka për obligim të evidentoj në regjistrin e pranimit dorëzimit të licencave.
8. OIK lirohet nga përgjegjësia e ruajtjes së licencave të cilat nuk tërhiqen nga anëtari brenda periudhës 6 mujore nga dita e njoftimit për gatishmërinë e saj për tërheqje. Në rast humbje pas këtij afati, anëtarit mund të kërkojë vetëm dublikatin e licencës.

Neni 18

Afatshmëria e licencës së punës

1. Licenca e punës për anëtarët e OIK, lëshohet me afat prej 5 (pesë) viteve e nënshkruar nga Kryetari i Odës sipas rekomandimit të Komisionit në procesverbal.
2. Në rast të humbjes së statusit të anëtarit të Odës, anëtarit i pushon validiteti i Licencës së punës.
3. Organi përkatës i Odës mund të informojë organet përkatëse në MSH, Inspektoratin Shëndetësor dhe punëdhënësin për skadimin e vlefshmërisë së Licencës së punës të anëtarit.

Neni 19

Përgjegjësia e përdorimit të licencës së punës

1. Licenca e punës i lëshohet anëtarit, në vetëm 1 (një) ekzemplar origjinal, ndërsa një kopje mbetet në dosjen e tij.
2. Licenca e punës në asnjë mënyrë nuk mund të përdoret nga ndonjë person tjetër në mënyrë që të arsyetojë ushtrimin e veprimtarisë të psikologut klinik.
3. E drejta për të ushtruar veprimtarinë në bazë të Licencës së lëshuar të punës, nuk mund të bartet e as të autorizohet te personi tjetër.
4. I licencuari është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e Licencës së punës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
5. Në rast të humbjes së licencës apo të dëmtimit të saj i licencuari duhet ta publikojë në njërin nga gazetatat ditore vendore apo ta paraqesë në polici. Fotokopjen e këtij publikimi duhet t'ia bashkëngjisë shkresës njoftuese për Odën.
6. Tërheqja e licencës bëhet nga anëtari personalisht, apo personit të autorizuar nga ana e palës.

Neni 20

Përmbajtja e dokumenti të licencës së punës

1. Autorizimi për punë të pavarur (licenca e punës) është dokument letre në format A4 dhe ka këtë përmbajtje:
 - 1.1 Në këndin e sipërm majtas të dokumentit gjendet stema e Republikës së Kosovës, ndërsa në këndin e sipërm djathtas gjendet e logo e Odës;

- 1.2 Në pjesën e sipërme të dokumentit shënohet baza juridike e lëshimit të licencës së punës;
 - 1.3 Në mes të dokumentit është emri i dokumentit "Licencë e punës". Nën tekstin e përmendur janë të dhënat për emrin dhe mbiemrin, titullin profesional, data dhe vendi i lindjes, numri personal/letërnjoftimit të mbajtësit të dokumentit dhe qëllimin e lëshimit të dokumentit, me tekstin: "Për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur në tërë territorin e Kosovës, meqë i plotëson kushtet e parapara me Ligj" ;
 - 1.4 Në pjesën e poshtme të dokumentit janë të dhënat e mbajtësit të dokumentit varësisht nga statusi profesional: numri i diplomës së studimeve apo certifikatës së provimit, numri identifikues i licencës (kodi), data e lëshimit dhe data e skadimit të licencës së punës;
 - 1.5 Në këndin e poshtëm majtas figuron QR CODI, ndërsa në këndin e poshtëm djathtas figuron nënshkrimi i kryetarit të OIK.
2. Dokumenti i licencës së punës shkruhet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Neni 21

Kopja e dublikuar e Licencës së punës

1. Me kërkesë të anëtarit të Odës, Zyra për Psikolog mund të lëshojnë Licencë pune të dublikuar, në rast se origjinali është humbur apo dëmtuar rënd, pas shpalljes së pavlefshme në ndonjërin gazetë ditore apo në polici, në të cilën do të shënohet se është dublikatë i Licencës së punës origjinale;
2. Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional do të lëshojë licencën e punës dublikatë në afat të përputhshëm me afatin e Licencës së punës origjinale;
3. Parashtruesi i kërkesës për lëshimin e Licencës së punës dublikatë, është i obliguar që të paguajë taksën administrative për këtë shërbim në përputhje me tarifat administrative në fuqi.

Neni 22

Aplikimi me vonesë për licencim/rilicencim

1. Nëse anëtari i Odës nuk i nënshtrohet procesimit të licencimi brenda afatit prej 5 vite nga dhënia e provimit shtetërorë për licencim, i nënshtrohet vlerësimit të aftësive/shkathtësive profesionale nga Komisioni përkatës i odës dhe/ose mbajtjes së stazhit profesional.
2. Nëse anëtari i Odës nuk i nënshtrohet procesimit të licencimi brenda afatit prej 5 vite nga përfundimi i stazhit profesional, i nënshtrohet vlerësimit të aftësive/shkathtësive profesionale nga Komisioni përkatës i odës dhe/ose mbajtjes së stazhit profesional.
3. Nëse anëtari i Odës nuk i nënshtrohet procesimit të rilicencimi brenda afatit prej 6 muaj nga skadimi i licencës, i nënshtrohet vlerësimit të aftësive/shkathtësive profesionale nga Komisioni përkatës i odës dhe/ose mbajtjes së stazhit profesional.
4. Procedura e provimit, stazhit dhe vlerësimit të aftësive/shkathtësive profesionale rregullohet përshtatshëmrisht me anëtarët të cilët nuk kanë plotësuar kriteret për EVP.

KAPITULLI VII

FAKSIMILI SI SHENJË E IDENTIFIKIMIT PERSONAL DHE PROFESIONAL

Neni 23

Mënyra e lëshimit dhe përdorimit të faksimilit

1. Psikologët klinik pajisen me faksimil, i cili shërben si shenjë e identifikimit personal dhe profesional.
2. Anëtari i Odës nga profilet si në paragrafin 1 të këtij neni, krahas kërkesës për faksimil duhet të dorëzoj kopjen e licencës së punës.
3. Faksimili përdoret gjatë ofrimit të drejtpërdrejtë të kujdesit shëndetësor, për vërtetimin e dokumentacionit mjekësor.
4. Një person tjetër nuk mund ta përdorë faksimilin në emër dhe për llogari të bartësit të faksimilit.

Neni 24

Përmbajtja e faksimilit

1. Faksimili ka këtë përmbajtje:
 - 1.1 Logo e Odës;
 - 1.2 Emrin dhe mbiemrin e të licencuarit;
 - 1.3 Thirrjen profesionale për të cilën është licencuar;
 - 1.4 Kodin e licencës së punës.
2. Madhësia dhe lloji i shkronjave në faksimil përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Odës.

Neni 25

Dorëzimi i faksimilit

1. Pronar i faksimilit është Oda, dhe si i tillë duhet t'i dorëzohet organit kompetent në të gjitha rastet përshtatshmërisht me dorëzimin e ID kartelës;
2. Të dhënat personale dhe të dhënat tjera relevante që evidentohen në Regjistrin e anëtarësisë së Odës, në Regjistrin e licencimit dhe rilicencimit, dokumentin e Licencës së punës dhe në faksimil, do të bazohen në dokumentin e lëshuar nga organi përkatës shëndetësor arsimor dhe nga organi i gjendjes civile, i cili nuk do të jetë më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj, apo letërnjoftimi me afat valid;
3. Në rast të dëmtimit apo humbjes së faksimilit nga anëtari i Odës, i njëjti është i obliguar që në afat sa më të shkurtër kohor ta njoftojë Odën dhe sipas mundësisë ta dorëzoj kërkesën (formularin) për faksimilin e dytë, bashkë me publikimin e humbjes së faksimilit në ndonjërin nga gazetatat ditore;
4. Në rast të mos përmbushjeve të detyrimeve nga ky nen, Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional inicion procedurën pranë Këshillit Etik për mos përmbajtje të detyrimeve nga anëtari.

Neni 26

Zbatimi i masave disiplinore të shqiptuara nga organet e mbikëqyrjes etike dhe profesionale

1. Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional është përgjegjëse për ekzekutimin e masave disiplinore përkitazi me revokimin e përkohshëm apo të përhershëm të licencës dhe heqjes nga regjistri i anëtarësisë dhe regjistri i licencave në pajtueshmëri me vendimet nga Organet e OIK;
2. Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional do të bëjnë ekzekutimin e masës disiplinore sipas urdhrit të organit kompetent që ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me procedurat e parapara për organet etike të OIK;
3. Me rastin e ekzekutimit të masës disiplinore sipas vendimit të organit kompetent, Zyra për Psikolog Klinik në kuadër të shërbimit profesional do të njoftojnë Këshillin Etik për ekzekutimin e masës së tillë, në mënyrë që të bëhet evidentimi i ekzekutimit të masës disiplinore në regjistrin e veçantë për masat e shqiptuara disiplinore.

Neni 27

Taksat administrative

1. Taksa administrative licencim dhe rilicencim caktohet me rregullore për caktimin e lartësisë së taksave administrative, e miratuar nga Kuvendi.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditë e miratimit të saj nga Kuvendi i Odës, ndërsa fillon të zbatohet nga 1 janari i vitit 2025;
2. Çështjet nga fushë veprimtaria materiale dhe procedurale e komisionit për licencimin dhe rilicencimin e psikologëve klinik të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore zgjedhën përshtatshmërisht me rregulloren e përgjithshme për licencimin dhe rilicencimin e profileve të OIK apo mund të procedohen në KD, deri në plotësim-ndryshimin e kësaj rregullore;
3. Në rast paqartësi, Interpretimi përfundimtar i saj bëhet nga Këshilli Drejtues i Odës;
4. Kjo rregullore publikohet në ueb faqen e odës.



Kryetare e OIK
Nexhmije Gori